



VENDIM

Nr. 77, Datë 08.06.2015

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LIÇENSIMIT TË
SHOQËRISË “HEC KABASH POROÇAN” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma ”a”; 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “g”; 5 pika 2 dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18, pika 1, gërma “a” të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.06.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “HEC KABASH POROÇAN” sh.p.k për liçensim në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “HEC KABASH POROÇAN” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gërmat “a”; “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për liçensë të shoqërisë “HEC KABASH POROCAN” sh.p.k në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI